



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHTJET PUBLIKE

Lindur në Tiranë në vitin 1962, z. Galanxhi është diplomuar nga Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i gjuhëve të huaja – Dega e gjuhës angleze, në vitin 1986. Z. Galanxhi ka pasur mundësinë të ndjekë kurse trajnimi intensive për Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Institutin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci të Gjenevës, Zvicër, në Institutin e Shërbimit të Jashtëm të Departamentit të Shtetit në Washington D.C., Shtetet e Bashkuara të Amerikës, respektivisht në vitet 1994 dhe 1995, si dhe kursin për Menaxhimin dhe Udhëheqjen e Lartë pranë misionit të Bashkimit Europian PAMECA në Tiranë, në vitin 2004. Aktualisht, z. Galanxhi është pedagog i gjuhës angleze në Universitetin Barleti, si dhe mban postin e ekspertit në Institutin Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA) pranë Universitetit Barleti. Kariera profesionale e z. Galanxhi ka qenë një bashkë-ekzistencë e mësim-dhënies dhe diplomacisë. Ai ka dhënë mësim në nivele të ndryshme, duke filluar nga shkolla e mesme dhe deri në universitete publike dhe private, qendra te trajnimit profesional, etj., si dhe ka pasur privilegjin të punojë për qeverinë shqiptare duke e përfaqësuar Republikën e Shqipërisë në postin e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), si dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Meksikë, Panama dhe Argentinë. Z. Galanxhi ka punuar gjithashtu edhe për Organizatat Ndërkombëtare prezente në Shqipëri, si UNHCR (Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët), dhe për misionet këshillimore policore të Bashkimit Europian në Shqipëri, si MAPE, ECPA dhe PAMECA.

Born in Tirana in 1962, Mr. Galanxhi graduated from Tirana State University, Faculty of Foreign Languages – English Language branch, in 1986. He also had the possibility of attending intensive training courses for Foreign Relations and Diplomacy at the Swiss International Relations Institute of Geneva, Switzerland, as well as at the Foreign Service Institute of the State Department in Washington D.C., the United States of America, respectively in 1994 and in 1995, as well as the Senior Management and Leadership Course at the EU PAMECA Mission in Tirana, in 2004. Mr. Galanxhi is a pedagogue of English language at Barleti University, as well as he holds the position of the expert at the Albanian Institute for Public Affairs (AIPA) of Barleti University. Mr. Galanxhi's professional career has been a co-existence of Teaching and Diplomacy. He has been teaching in different levels, from high school to public and private universities, professional training centers, etc., as well as he enjoyed the privilege of working for the Government of Albania, representing the Republic of Albania in the post of the Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary in the United Nations Organization (UNO), in the Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE), as well as in the United States of America, Mexico, Panama and Argentina. Mr. Galanxhi has also worked for the International Organizations present in Albania, such as the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR), and for the EU Police Advisory Missions in Albania, such as MAPE, ECPA and PAMECA.